



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA  
GJYKATA THEMELORE MITROVICË

---

Numri i lëndës: 2019:225288  
Datë: 08.04.2024  
Numri i dokumentit: 05558610

**C.nr.386/2017**

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**, Departamenti i përgjithshëm, Divizioni civil, me gjyqtarin Fuad Haliti, në kontestin e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit(BKS) me seli në Prishtinë, rr."Lidhja e Pejës" magjistratja Prishtinë-Fushë Kosovë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Blinera Gashi, kundër të paditurit A... H...., me adresë në fshatin Shupkovc në Mitrovicë, për shkak të rimbursimit të dëmit, vlera e kontestit 12715.00€. pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, me datën 08.04.2024, mori këtë:

### **A K T G J Y K I M**

- I. APROVOHET** në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit(BKS), dhe **OBLIGOHET** i paditurit A... H... që paditëses BKS t'i rimburoj shumën në lartësi prej 12,715.00€, në emër të rimbursimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut të datës 09.10.13 në Serbovac - Zvecan dhe atë me kamatë sipas mjeteve të deponuara në bankat afariste mbi një vit pa destinim të caktuar, duke llogaritur nga dita e ngritjes së padisë e deri në pagesën përfundimtare.
- II. OBLIGOHET** i paditurit që paditëses t'ia paguaj shpenzimet procedurale dhe atë në lartësi prej 100.00€ në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

### **Arsyetim**

#### **1. Pretendimet e palëve**

Paditësja me datën 12.07.2017 pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi, përmes së cilës ka kërkuar që të obligohet i padituri A... H... që paditëses BKS t'i rimburoj shumën në lartësi prej 12,715.00€, në emër të rimbursimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut të datës 09.10.13 në Serbovac - Zvecan.

E autorizuar e paditëses, në seancën e shqyrtimit kryesor deklaroi se mbesim në tërësi pranë padisë dhe kërkesës së saj ashtu që nga provat e bashkangjitura në padi vërtetohet se i padituri në ditën e aksidentit përpos që nuk kishte mbulesë siguroese i njëjti me veprimin e tij të kundërligjshëm dhe nga pakujdesia kaloi në shiritin e kundërt me ç'rast shkaktonte aksident me

fatalitet. Përitazi me këto dëme të shkaktuara, pala e dëmtuar kishte paraqitur kërkesë për kompensim, ashtu që në bazë të marrëveshjes së datës 10.02.2014 në mes të BKS-së dhe të dëmtuarit, palët ishin marrë vesh për zhdëmtim në vlerë prej 12,715.00€, me pas me datën 18.02.2014 ishte ekzekutuar shuma në llogari të avokatit të familjes së të ndjerit. Tani në këtë fazë nga i padituri kërkohet që komfor Ligjit për Sigurim të Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia dhe Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, kërkohet rimbursimin e dëmit të shkaktuar. Shpenzimet procedurale i kërkohet.

## **2. Provat e administruara**

Për vërtetimin e plotë të gjendjes faktike dhe fakteve vendimtare, gjykata gjatë shqyrtimit kryesor ka bërë administrimin dhe vlerësimin e këtyre provave: Transferi bankar i datës 18.02.2014, ujdia jashtëgjyqësore e datës nr.2179/13 e datës 16.02.2014, vendimi i datës 28.01.2014, kërkesa për dëmshpërblim e datës 19.11.2013, raporti policor i aksidentit nr.2013-ST-012 i datës 09.10.2013 dhe konfirmimi i sigurimit i datës 20.11.2013.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palës paditëse dhe provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është **e bazuar**.

## **3. Faktet**

Me leximin e kërkesës për dëmshpërblim e datës 19.11.2013, gjykata vërtetoi faktin se Q... H..., N... H..., L... H... dhe A... H... me datën 19.11.2013 kanë kërkuar nga paditësja kompensimin e dëmit jomaterial dhe material në vlerë prej 12,715.00€.

Me leximin e vendimit të datës 28.01.2014, ujdisë jashtëgjyqësore e datës nr.2179/13 e datës 16.02.2014, transferit bankar i datës 18.02.2014, gjykata vërtetoi faktin se paditësja ka marrë vendim me të cilin është miratuar kërkesa e familjes H... nga Mitrovica në shumën e përgjithshme prej 12,715.00€ dhe për këtë kanë arritur ujdinë jashtë gjyqësore të cilën e kanë ekzekutuar përmes transferimit të mjeteve në xhirollogarinë bankare të të autorizuarit të familjes H... dhe atë në shumën prej 12,715.00€.

Me leximin e raportit policor të aksidentit nr.2013-ST-012 i datës 09.10.2013, gjykata vërtetoi faktin se i padituri me datën 09.10.2013, ka shkaktuar aksident në të cilin ka mbetur i vdekur A... H... i cili ka qenë familjari i personave të cilët paditësja i ka dëmshpërblyer.

Me leximin e konfirmimit të sigurimit i datës 20.11.2013, gjykata vërtetoi faktin se i padituri në momentin e shkaktimit të aksidentit të datës 09.10.2013, nuk kishte mbulesë siguruese për automjetin e tij.

## **4. Baza ligjore**

Sipas nenit nenit 18 paragrafi 1 dhe 4 të Ligjit mbi Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, parashihet që *“Personi i dëmtuar të cilit i është shkaktuar dëmi brenda territorit të Republikës së Kosovës nga një mjet motorik, pronari i të cilit nuk është i mbuluar nga sigurimi i autopërgjegjësive, ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblimin e dëmit nga Byroja.”*, ndërsa në paragrafin 4 përcaktohet se *“Byroja ka të drejtë regresi për këto dëme nga personi përgjegjës dhe atë për shumën e paguar, shpenzimet dhe kamatat.”*

### **1. Vlerësimet faktike dhe juridike të gjykatës**

Pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha pretendimet e palëve ndërgjyqëse dhe provave të administruara në këtë çështje kontestimore, gjykata ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është **e bazuar**.

Pas vlerësimit të provave gjykata vërtetoi se i padituri A.... H.... me datën 09.10.2013 ka shkaktuar aksident trafiku me automjetin të llojit Golf II, me targa të regjistrimit ..... dhe me këtë rast i shkakton dëm familjes H.... për shkak se në këtë aksident humb jetën familjari i tyre A.... H.... Në bazë të raportit policor por edhe në bazë të komfirmimit të sigurimit i datës 20.11.2013, ngasësi i automjetit në momentin e shkakimit të dëmit ka qenë pa mbulesë siguruese, respektivisht me afat të skaduar të policës së sigurimit. Pasi që në rastin konkret shkaktari i aksidentit – i padituri A... H.... nuk kishte mbulesë siguruese, sipas nenit 18 paragrafi 1 i Ligjit mbi Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, *“Personi i dëmtuar të cilit i është shkaktuar dëmi brenda territorit të Republikës së Kosovës nga një mjet motorik, pronari i të cilit nuk është i mbuluar nga sigurimi i autopërgjegjësive, ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblimin e dëmit nga Byroja.”*, në këtë rast paditësja i ka kompensuar dëmin material dhe jomaterial familjes H....., të pësuar i rezultat i aksidentit, ndërsa sipas paragrafit 4 të po këtij neni përcaktohet se *“Byroja ka të drejtë regresi për këto dëme nga personi përgjegjës dhe atë për shumën e paguar, shpenzimet dhe kamatat.”* Andaj, paditësja ka të drejtë që mjetet e paguara për kompensim dëmi, t’i regresoj nga personi përgjegjës dhe në këtë rast i padituri është përgjegjës për rimbursimin e dëmit ndaj paditëses.

Nga të lartcekurat dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 dhe 4 të Ligjit mbi Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia Ligji.nr.04/L-018 gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marr komfor nenit 449 dhe 452 paragrafi 1 i LPK-së, ashtu që i padituri ka obligim t’ia kompensoj paditëses shpenzimet në lartësi prej 100€, në emër të taksës gjyqësore.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
**Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil**  
**C.nr.386/2017, datë 08.04.2024**

**Gjyqtari**  
**Fuad Haliti**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite pas marrjës së të njejtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj gjykate.